

Në bazë të nenit 250, 253 dhe 256, paragrafi (1) pika 1) të Ligjit të Mbrojtës Shëndetësore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16 dhe 20/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “Nr. 101/19 dhe 153/19), dhe nisi 17 nga Statuti i Odës së Mjekëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendi i Odës së Mjekëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me datën 17.12.2019, e miratoi këtë

STATUT

TË ODËS SË MJEKËVE

TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

(teksti i konsoliduar)

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

(1) Oda e Mjekëve e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejmë: Oda) është organizatë e pavarur profesionale e të gjithë mjekëve të mjekësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 2

(1) Me këtë Statut rregullohet:

- 1) emri dhe selia e Odës;
- 2) qëllimet dhe detyrat e Odës;
- 3) të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Odës;
- 4) organet e Odës, procedura, mënyra e përgjedhjes, përbërja dhe kompetencat;
- 5) financimi i Odës;
- 6) akte tjera të përgjithshme;
- 7) çështje tjera të rëndësishme për veprimtarinë dhe profesionin mjekësor

Neni 3

(1) Oda e ka cilësinë e subjektit juridik me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes Shëndetësore, ligjet tjera dhe me këtë Statut

(2) Oda i kryen autorizimet publike në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes Shëndetësore

(3) Oda vepron në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe përfaqëson interesat e të gjithë mjekëve të mjekësisë që janë anëtarë të Odës së mjekëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Puna e Odës dhe organeve të saj është publike.

Neni 4

(1) Në qarkullimet juridike me palën të tretë, Oda vepron në emër të vet në mënyrë të pavarur dhe për llogarinë e vetë me mjetet e veta.

(2) Odën në qarkullimet juridike e përfaqëson kryetari i Odës.

(3) Në mungesë të kryetarit të Odës, në kuadër të autorizimeve të tij, Oda në qarkullimet juridike përfaqësohet nga zëvendëskryetari i saj.

2. EMRI DHE SELIA E ODËS

Neni 5

Emri i Odës është: ODA E MJEKËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT.

(2) Emri i shkurtuar i Odës është: OMRMV.

(3) Emri i Odës në shqip është: Oda e Mjekëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose emri i shkurtuar: OMRMV

(4) Emri i Odës në anglisht është: Doctor's Chamber of the Republic of North Macedonia.

(5) Selia e Odës është në Shkup në Bul. "Aradhet Partizane" nr. 3, Qendër, Shkup.

(6) Objekti në të cilin është vendosur Oda duhet ta ketë emrin, mbishkrimin dhe shenjën e Odës.

Neni 6

1) Oda ka vulë dhe vulë katrore.

(2) Vula e Odës e ka formën e rrumbullakët, me dimension 5 cm, dhe me përmbajtje të tekstit në gjysmërrreth: "ЛЕКАРСКА КОМОРА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА- Скопје; ODA E MJEKËVE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VVERIUT- Shkup. Në mes të vulës është shenja e Odës.

(3) Vula katrore e Odës e ka formën e drejtkëndëshit në të cilën horizontalisht është shkruar emri i Odës në gjuhën maqedonase dhe shqipe dhe selia e Odës dhe hapësirë për evidentimin e numrit dhe të datës së protokollit afarist.

(4) Vulë kanë dhe Këshillat e Odës.

(5) Vula e Odës ka formë të rrumbullakët, të dimensionit 4 cm, me përmbajtje të tekstit në gjysmërrreth: "ODA E MJEKËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VVERIUT- Shkup" dhe emri i Bordit. Në mes të vulës është shenja e Odës.

(6) Në Bordet ku janë të anëtarësuar më së paku 20% e mjekëve të mjekësisë, që e flasin gjuhën zyrtare ndryshe nga maqedonishtja, vula e bordit është e shkruar në gjuhën maqedonase me alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që flasin të paktën 20% të anëtarëve dhe letrat e tyre.

(7) Oda ka një shenjë (logo) në të cilën formën, pamjen dhe dizajnin e përcakton Kuvendi me vendim të veçantë.

(8) Ueb faqja zyrtare e Odës është: www.lkm.org.mk

(9) Gazeta e Odës botohet me titullin: "VOX MEDICI", forma dhe përmbajtja e të cilës rregullohet me akt nënligjor.

3. QËLLIMET DHE DETYRAT E ODËS

Neni 7

(1) Qëllimet e Odës janë:

1) mbrojtja dhe promovimi i profesionalizmit me obligimet dhe të drejtat etike të mjekëve të mjekësisë;

2) përmirësimi i cilësisë së mbrojtjes shëndetësore dhe mbrojtja e interesave të profesionit mjekësor;

- 3) përcjellja e raportit të mjekëve të mjekësisë ndaj shoqërisë dhe qytetarëve;
- 4) mbrojtja e të drejtave dhe interesave profesionale të mjekëve të mjekësisë që janë anëtarë të saj dhe kujdesi për dinjitetin, reputacionin, integritetin dhe promovimin e profesionit të përgjithshëm mjekësor dhe ushtrimin e të njëjtët në mënyrë të ndershme dhe korekte;
- 5) sigurimin e performancës së organizuar të mjekëve të mjekësisë para organeve shtetërore, Fondit për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe institucioneve shëndetësore;
- 6) avancimin e profesionit të përgjithshëm të mjekësisë për ushtrimin e të njëjtët në mënyrë korakte dhe të ndershme;
- 7) dhënien e propozimeve dhe sugjerimeve për organizimin e mbrojtjes shëndetësore të të gjitha niveleve dhe institucioneve të sistemit, të gjitha në interes të qytetarëve dhe mjekëve të mjekësisë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 8

- 1) Oda i kryen këto detyra:
 - 1) kujdeset, monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e rregullave të mjekësisë etike dhe deontologjisë dhe në rastin e shkeljes së tyre merr masa;
 - 2) kujdeset për mbrojtjen e nderit dhe pavarësisë së profesionit mjekësor;
 - 3) I lëshon, vazhdon, merr dhe rinovon licencat e mjekëve të mjekësisë dhe evidenton regjistrin e licencave të lëshuara, të vazduara, të marra(revokuara) dhe të rinovara;
 - 4) I përcakton sasinë e vlerës së shumës dhe shpenzimeve për lëshimin, vazhdimin dhe rinoimin e licencës për punë;
 - 5) E mbikëqyr punën profesionale të institucioneve shëndetësore dhe institucioneve të tjera të cilët kryejnë veprimtari shëndetësore edhe të punonjësve shëndetësorë dhe të bashkëpunëtorëve;
 - 6) E miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore;
 - 7) I miraton aktet e përgjithshme për të cilat është e autorizuar me Ligjin e Mbrotjes Shëndetësore dhe ligje tjera;
 - 8) E organizon dhe e zhvillon provimin profesional të mjekëve të mjekësisë, e përcakton programin për trajnime plotësuese dhe organizon dhe kryen kontrollimin e njojurive dhe aftësive profesionale të mjekëve të mjekësisë;
 - 9) E koordinon dhe akrediton përsosjen e vazdueshme profesionale dhe avancimin profesional të anëtarëve të saj për shkak të zhvillimit të vazdueshëm profesional;
 - 10) E ngritë dhe jep iniciativa për miratimin dhe ndërtimin e mendimeve dhe jep propozimet lidhur me ligjet, rregulloret, strategjitë dhe masat e tjera në fushën e mbrojtjes shëndetësore;
 - 11) merr pjesë në procesin e marrëveshjes me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore për përcaktimin e vlerës së punës së mjekëve të mjekësisë;
 - 12) bashkëpunon me organet dhe institucionet kompetente në përcaktimin e qëndrimeve profesionale në kryerjen e veprimtarisë mjekësore;
 - 13) inicion dhe ndërmerr procedura në rast të ushtrimit të paautorizuar dhe të kundërligjshme të veprimtarisë mjekësore;

- 14) bashkëpunon me oda të tjera, institucion, shoqata relative mjekësore dhe shoqata tjera dhe asociacione për çështje me interes të përbashkët, në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe më gjerë;
- 15) në bazë të gjendjes aktuale të mjekëve të mjekësisë të regjistruar, vendit dhe përvojës së tyre të punës, kryen projektimin e numrit aktiv të mjekëve të mjekësisë në të gjitha fushat e veprimtarisë shëndetësore sipas rajoneve;
- 16) jep mendim dhe propozim Ministrisë së Arsimit dhe fakultetit të mjekësisë për numrin e studentëve të regjistruar në mjekësi dhe në lidhje me politikën e regjistrimit;
- 17) propozon dhe jep mendime në lidhje me numrin dhe llojet e specializimeve të mjekëve të mjekësisë;
- 18) jep propozim dhe mendim Ministrisë së Shëndetësisë për rrjetin e institucioneve shëndetësore në të cilën kryhet veprimtari mjekësore;
- 19) boton një revistë periodike informativo-profesionale;
- 20) bashkëpunon me organet shtetërore për arritjen e qëllimeve dhe detyrave të Odës;
- 21) kryen punë të tjera në përputhje me ligjet, rregulloret, Kodin e etikës dhe deontologjisë Mjekësore dhe me këtë Statut.

4. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ODËS

Neni 9

Anëtarësimi në Odë është obligim dhe nderë për të gjithë mjekët në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

- (2) Anëtarësia në Odë është e drejtë dhe obligim i të gjithë mjekëve të mjekësisë që kryejnë veprimtari mjekësore, duke përfshirë edhe shtetasit e huaj.
- (3) Në arritjen e qëllimeve dhe detyrave të Odës, anëtarët e Odës realizojnë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe këtë Statut.
- (4) Në ushtrimin e të drejtave dhe obligimeve të gjithë anëtarët e Odës janë të barabartë.

Neni 10

(1) Anëtar i Odës mund të jetë doktor i mjekësisë i cili ka kryer veprimtari shëndetësore në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i papunë dhe doktor i mjekësisë i cili është punonjës jashtë sistemit shëndetësor dhe mjek i mjekësisë – shtetas i huaji cili përkohësisht qëndron dhe ushtron veprimtari shëndetësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ka licencë të lëshuar nga Oda.

(2) Anëtar nderi i Odës mund të jetë shkencëtar, profesor ose qytetar tjetër duke përfshirë një shtetas të huaj që ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e veprimtarisë arsimore, në veprimtari aplikative ose në punë shkencore në fushën e mjekësisë, ose ai që në veçanti është theksuar në përvojën e tij profesionale ose në një mënyrë tjetër e ka dhënë kontributin e tij në punën e Odës.

(3) Anëtarët e nderit të Odës i zgjedh Kuvendi i Odës me propozim të Këshillit Ekzekutiv.

Neni 11

(1) Anëtarët e Odës i kanë këto të drejta dhe obligime:

- 1) Të drejtën për të zgjedhur organet dhe trupat e Odës dhe e drejta për t'u zgjedhur;
- 2) të drejtën për ndihmë këshilluese-juridike për çeshtje të natyrës profesionale;
- 3) të drejtën për këshilla dhe mbështetjen profesionale mjekësore;
- 4) të drejtën për të shfrytëzuar përfitimet që ka lidhur Oda me persona të tjera juridikë dhe persona fizikë;
- 5) të drejtën për ndihmë financiare anëtarit të Odës në pajtim me aktet e Odës;
- 6) të drejtën për kopje falas të revistës së Odës;
- 7) detyrimin që t'i respektojnë dhe t'i përbajnë të gjitha rregulloret e miratuara nga organet e Odës, veçanërisht Kodin e Etikës mjekësore dhe Deontologjisë dhe këtë Statut;
- 8) obligimin për respektimin e akteve të aprovuara nga organet e Odës;
- 9) obligimin për të informuar Odën për të gjitha ndryshimet në punësim, arsim, profesionalizëm, zhvillim shkencor dhe arsimor, si dhe ndryshimet e të dhënavë profesionale, në pajtim me aktet e Odës;
- 10) obligimin për të siguruar informata të nevojshme për krahasimin e rregullt të aktiviteteve në Odë;
- 11) obligimin për të bashkëpunuar dhe për të marrë pjesë në mbikëqyrje profesionale në përputhje me aktet e Odës;
- 12) obligimin për pagesën e rregullt të anëtarësimit dhe të gjitha detyrimet financiare të cilat rrjedhin nga anëtarësimi në Odë;
- 13) obligime të tjera që dalin nga ky statut dhe aktet e Odës.

Neni 12

(1) Anëtarësia në Odë pushon në rast të:

- 1) heqjes së përhershme të licencës;
- 2) heqjes së përkohshme të licencës;
- 3) kërkesës së anëtarit të Odës;
- 4) vdekjes së anëtarit të Odës.

(2) Me përfundimin e anëtarësimit, anëtarit i pushojnë (ndërpriten) të gjitha të drejtat, obligimet dhe veprimtaritë në Odë.

5. ORGANET E ODËS, PROCEDURA, ZGJEDHJA, PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT

Neni 13

(1) Organet e Odës janë:

- 1) Kuvendi;
- 2) Këshilli Ekzekutiv;
- 3) Këshilli Mbikëqyrës;
- 4) Kryetari i Odës;
- 5) Zëvendëskryetari i Odës;
- 6) Nënkyetarët e Odës;
- 7) Gjykata e Nderit;
- 8) Prokurori i Odës, dhe
- 9) Zëvendësit e Prokurorit të Dhomës.

(2) Organet e Odës në kuadër të fushëveprimit në punë sjellin rregullore, vendime, aktvendime, konkluzione, deklarata, rekomandime, propozime, marrin qëndrime dhe mendime në përputhje me ligjet, Statutin dhe aktet e tjera të Odës.

Neni 14

(1) Procedura për zgjedhjen, përkatesisht emërimin dhe mënyra e shkarkimit, përkatesisht térheqjen e anëtarëve të organeve të Odës, si dhe përfundimi mandatit të tyre janë të rregulluar me ligj, me Statut dhe aktet e Odës.

(2) Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të organeve të Odës duhet të merret parasysh kualiteti personal i individit, përfaqësimi adekuat i gjithë profilit profesional, përfaqësimi rajonal, gjinor dhe etnik i anëtarëve të Odës, ku zbatohet parimi i përfaqësimit adekuat dhe e drejta e të gjitha komuniteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Nëse në organet e Odës zgjidhet anëtar i Odës, i cili në të njëjtën kohë është kryetar i një forme të organizuar të shoqatës në fushën e shëndetësisë, posti i kryetarit në atë shoqatë përfundon me zgjedhjen e tij në organet e Odës.

Neni 15

(1) Mandati i delegatëve të Kuvendit zgjat 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje dhe fillon të rrjedhë nga seanca konstitutive e Kuvendit,

(2) Mandati i organeve të Odës zgjat 4 (katër) vjet, me të drejtën e rizgjedhjes, me përjashtim të anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv dhe Mbikëqyrës të cilët zgjidhen në periudhë më së paku 4 (katër) vjet të cilët mund të zgjidhen edhe një herë dhe fillon të rrjedhë nga seanca konstitutive e Kuvendit.

3) Mandati i anëtarëve në organet e Odës përfundon:

- 1) me skadimin e mandatit;
- 2) duke dhënë dorëheqje;
- 3) me ndërprerjen e anëtarësimit në Bordin/Këshillin komunal nga i cili është deleguar;
- 4) me térheqjen/revokimin nga Bordi Komunal në të cilin është deleguar;

5.1. Kuvendi i Odës

Neni 16

(1) Kuvendi i Odës (në tekstin e mëtejmhë: Kuvendi) është organi më i lartë në drejtimin dhe vendimet e Odës.

(2) Kuvendin e zgjedhin anëtarët e Odës në zgjedhje të drejtpërdrejta, të lira dhe të fshehta.

(3) Kuvendi përbëhet nga delegatë (përfaqësues) të anëtarëve të Odës sipas parimit, nga çdo Këshill i Odës zgjidhet një anëtar i Kuvendit, që është Kryetar i Bordit/Këshillit Komunal. Në Këshillat me mbi 150 (pesëdhjetë) anëtarë, zgjidhet një delegat i dytë, dhe në Këshillat me mbi 250 (dyqind e pesëdhjetë) anëtarë zgjidhet delegati i tretë në Kuvendin e Odës, duke marrë në konsideratë përfaqësimin e duhur dhe të drejtë të pjesëtarëve të komuniteteve që numërojnë 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së RMV-së.

(4) Kuvendi përbëhet nga 79 (shtatëdhjetë e nëntë) delegatë, duke mos përfshirë Kryetarin e Odës, zëvendësin e tij dhe tre nënkyetarët, të cilët janë delegatë në detyrë, me të drejtë vote.

(5) Delegatët e Kuvendit zgjidhen nga radhët e anëtarëve të Odës, të organizuar në Këshillat e Odës, me votim të fshehtë.

(6) Zgjedhjet për delegatë në Kuvend i shpall kryetari i Odës jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë para skadimit të mandatit të Kuvendit.

(7) Zgjedhjet i përgatitë dhe i zbaton Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Odës së Mjekëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 17

(1) Kuvendi kryen këto punë:

- 1) E miraton Statutin e Odës dhe bën ndryshime dhe plotësime në të;
- 2) E miraton Programin vjetor për punën e Odës, planin financiar dhe raportet për zbatimin e tyre;
- 3) vendos për lartësinë e anëtarësimit;
- 4) vendos emërimin dhe shkarkimin e organeve të Odës;
- 5) E zgjedh dhe e shkarkon kryetarin e Kuvendit dhe nënkyetarët e Kuvendit;
- 6) I zgjedh dhe i shkarkon mbrojtësit;
- 7) I formon komisionet e përhershme, zgjedh dhe i shkarkon kryetarët e tyre dhe anëtarët me propozim të Kryetarit të Odës;
- 8) E miraton Rregulloren e Punës së Kuvendit;
- 9) E miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore;
- 10) E miraton Rregulloren për zgjedhjet dhe tërheqjen/revokimin e anëtarëve të organeve të Odës;
- 11) E miraton llogarinë përfundimtare me raportin financiar;
- 12) E shqyrton dhe sjell vendime, konkluzione, deklarata, rekomandime, përcakton qëndrime dhe jep mendime për çështje të rëndësishme, për punën e Odës;
- 13) I miraton aktet juridike dhe veprat juridike të Kryetarit të Odës dhe aktet juridike të Këshillit Ekzekutiv, vlera e të cilit i kalon 10,001,00 euro (dhjetë mijë e një euro) në kundërvlerë me denarë;
- 14) vendos për shpërndarjen e parakohshme të Kuvendit;

15) vendos për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të organeve të Odës për 6 (gjashtë) muaj të tjërë në gjendje të jashtëzakonshme dhe

16) kryen punë të tjera të përcaktuara me ligje dhe akte të Odës.

Neni 18

(1) Kuvendi i Odës punon në seanca.

(2) Kuvendi mund të punojë nëse në seancë janë prezentë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm i delegatëve.

(3) Kuvendi vendos në mënyrë të plotfuqishme me shumicën e votave të delegatëve të pranishëm dhe gjatë kësaj nëse kanë votuar 1/3 e numrit të përgjithshëm të delegatëve në Kuvend.

(4) Vendimi në Kuvend bëhet me votim publik, përvèç nëse Kuvendi vendos që të jetë në fshehtësi.

Neni 19

1) Seancat e Kuvendit i thërret dhe i drejton kryetari i Kuvendit.

(2) Kryetari i Kuvendit zgjidhet në seancën konstitutive-zgjedhore të Kuvendit nga radhët e delegatëve të zgjedhur të Kuvendit, me propozimin e së paku 1/3 (një të tretës) së delegatëve të Kuvendit, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të delegatëve në Kuvend, me votim publik.

(3) Kryetari i Kuvendit mund të shkarkohet me propozimin e së paku 1/3 (një të tretës) së delegatëve të Kuvendit ose së paku 3 (tre) Këshilla të Odës, me votim publik.

(4) Kryetari i Kuvendit mund të shkarkohet me 2/3 (dy të tretat) me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të delegatëve në Kuvend, me votim publik.

(5) Kuvendi në seancën e parë konstituivo-zgjedhore zgjedh dy nënkyetarët e Kuvendit nga radhët e delegatëve të zgjedhur në Kuvend, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të delegatëve në Kuvend, me votim publik.

(6) Nënkyetari i Kuvendit mund të shkarkohet me propozimin e Kryetarit të Kuvendit ose me propozimin e së paku 1/3 (një të tretës) së delegatëve të Kuvendit, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i delegatëve në Kuvend, me votim publik.

(7) Kryetari i Kuvendit cakton se cili nga dy nënkyetarët do ta zëvendësojë atë në rast të pengesës së tij, cili ta thërret dhe drejton seancën e Kuvendit, në të kundërtën seancën e drejton delegati më i vjetër i Kuvendit.

(8) Seancat e Kuvendit janë zgjedhore-konstitutive, të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

(9) Mënyra e thirrjes së seancave dhe mënyra e funksionimit të Kuvendit rregullohet me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Neni 20

(1) Kryetari i Kuvendit:

- 1) I thërret dhe i udhëheq seancat e Kuvendit;
- 2) merr pjesë në përgatitjen e materialeve për seancën;
- 3) kujdeset për zbatimin e vendimeve dhe konkluzioneve të Kuvendit;

- 4) merr pjesë në punën e Këshillit Ekzekutiv;
- 5) bashkëpunon me kryetarët e komisioneve dhe organeve parlamentare;
- 6) kryen punë të tjera në pajtim me ligjin, Statutin dhe aktet tjera të Odës.

Neni 21

- (1) Në seancat e Kuvendit, me ftesën e Kryetarit të Kuvendit, mund të marrin pjesë persona të tjerë me të drejtë pjesëmarrjeje në diskutim, por pa të drejtë vote.

Neni 22

- (1)** Kuvendi i Odës e ka Rregulloren e Punës, e cila për së afërmë e rregullon mënyrën e njofimit të seancave të Kuvendit, punën, votimin, vendimet, mbajtjen e procesverbaleve të seancave të Kuvendit dhe çështjet e tjera në interes për Kuvendin.

5.2. Bordi Ekzekutiv i Odës

Neni 23

- (1) Bordi Ekzekutiv për punën e tij përgjigjet para Kuvendit dhe kryen gjërat si më poshtë:
 - 1) i propozon Kuvendit miratimin e Programit të punës së Odës dhe planin financiar të Odës;
 - 2) i shqyrton dhe miraton propozimet për materialet për seancat e Kuvendit të Odës;
 - 3) e zbaton programin e punës dhe planin financiar dhe vendimet tjera të Kuvendit dhe parashtron raport në Kuvend për punën e vet;
 - 4) i shqyrton propozimet e anëtarëve për veprimin e Odës;
 - 5) i formon organet e përkohshme (komisione, grupe pune etj), zgjedh dhe i shkarkon kryetarët dhe anëtarët e tyre, diskuton për propozim-aktivitetet e planifikuara dhe raportet e tyre;
 - 6) e miraton planin vjetor për mbikëqyrje profesionale në punën e institucioneve shëndetësore dhe punonjësit shëndetësore;
 - 7) i miraton aktet juridike dhe veprat juridike të Kryetarit të Odës vlera e të cilave i kalon 3001.00 euro (tremijë e një euro), por nuk i kalon 10.000.00 euro (dhjetë mijë euro) në kundërvlerë në denarë;
 - 8) e paraqet në Kuvend raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare;
 - 9) vendos për lartësinë e tarifave për shërbimet që kryen Oda;
 - 10) vendos për lartësinë e tarifave për shërbimet e kryera nga personat që nuk janë të punësuar në Odë dhe për lartësinë e pagave të punëtorëve me propozimin e mëparshëm nga Kryetari i Odës;
 - 11) me propozimin e kryetarit të Odës, zgjedh kryeredaktorin dhe redaktorin përgjegjës dhe bordin redaktues të Informatorit të Odës;
 - 12) e miraton Rregulloren e punës;
 - 13) i sjell vendimet si organ i shkallës së dytë, përveç çështjeve që janë në kompetencë të Kuvendit dhe Odës dhe Gjykatës së Nderit;

14) e mbikëqyr punën e shërbimit profesional, vendos për themelimin dhe ndërprerjen e marrëdhënie së punës të punëtorëve në shërbimin profesional dhe vendos mbi ankesat dhe aktvendimet nga marrëdhënia e punës të miratuara në Shkallë të parë;

15) i parashtron Kuvendit propozim për ndryshime dhe plotësimë të Statutit;

16) i kryen punë e tjera nga fushëveprimi i tij të përcaktuara me Statut ose akte të tjera të Odës;

Neni 24

(1) Bordi Ekzekutiv është organ ekzekutiv i Odës dhe funksionon në pajtim me ligjin, statutin dhe aktet e tjera të Odës;

(2) Bordi ekzekutiv ka 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë nga të cilët 9 (nëntë) anëtarë i zgjedh Kuvendi nga radhët e delegatëve të Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Odës, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të delegatëve në Kuvend;

(3) Kryetari i Odës, Zëvendëskryetari i Odës, Kryetari i Kuvendit dhe tre Zëvendëskryetarët e Odës, sipas funksionit janë anëtarë të Këshillit Ekzekutiv, me të drejtë vote;

(4) Anëtarë i Këshillit Ekzekutiv mund të shkarkohet me kërkesë të Kryetarit të Odës, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të delegatëve në Kuvend, me votim publik;

Neni 25

(1) Bordi ekzekutiv punon në seancë;

(2) Seancat e Këshillit Ekzekutiv i thërret dhe i drejton Kryetari i Odës;

(3) Kryetari i Odës është i detyruar të thërrasë seancë me kërkesën e gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv.

(4) Mënyra e punës së Bordit Ekzekutiv rregullohet me Rregulloren e punës.

5.3 Këshilli Mbikëqyrës

Neni 26

(1) Këshilli Mbikëqyrës është organ i pavarur i Odës që mbikëqyr:

1) përdorimin e fondeve të Odës, aktivitetet materiale dhe financiare të Odës dhe Fondin Solidar;

2) realizimin e të drejtave dhe kryerjen e detyrimeve të anëtarëve të Odës;

3) punën e Arkës së Odës;

4) librat dhe aktet që kanë të bëjnë me përfitimet materiale, në pronën e Odës;

5) shfrytëzimin e mjeteve për punën e shërbimit profesional të Odës;

6) kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë Statut ose çka do t'i besohet nga Kuvendi ose Këshilli Ekzekutiv i Odës;

Neni 27

- (1) Këshilli Mbikëqyrës ka 5 (pesë) anëtarë të cilët zgjidhen nga anëtarët e Odës, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i delegatëve në Kuvendin e Odës;
- (2) Anëtarë i Këshilli Ekzekutiv mund të shkarkohet me propozimin e së paku 1/3 (një të tretës) së delegatëve të Kuvendit ose me propozimin e Kryetarit të Odës, me shumicën e numrit të përgjithshëm të delegatëve në Kuvend, me votim publik;
- (3) Këshilli Ekzekutiv për punën e tij është përgjegjës para Kuvendit dhe i parashtron raport sipas nevojës, të paktën një herë në vit;
- (4) Mënyra e punës së Këshillit Mbikëqyrës përcaktohet me Rregulloren e Punës.

5.4 Kryetari, Zëvendëskryetari dhe Nënëkryetari i Odës

Neni 28

- (1) Kryetari i Odës i kryen këto punë:
 - 1) E përfaqëson Odën dhe e drejton punën e saj në përputhje me këtë Statut dhe ligj;
 - 2) I nënshkruan të gjitha vendimet dhe aktet e Odës;
 - 3) I nënshkruan të gjitha dokumentet nga punët materiale dhe financiare të Odës së bashku me Zëvendëskryetarin e Odës;
 - 4) I thërrret dhe i drejton seancat e Këshillit Ekzekutiv dhe kujdeset për zbatimin dhe implementimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli Ekzekutiv dhe Kuvendi;
 - 5) I parashtron Kuvendit raport me shkrim për punën e tij, dhe për punën e organeve të Odës;
 - 6) kujdeset për realizimin e bashkëpunimit me oda, shoqata, institucione, organe dhe organizata në fushën e shëndetësisë;
 - 7) miraton akte juridike dhe lidh marrëveshje për akte juridike, vlera e të cilave nuk kalon 3.000,00 (tre mijë) euro në kundërvlerë në denarë dhe vepra të tjera juridike dhe akte juridike në të cilën vlera tejkalon 3.000,00 (tre mijë) euro në kundërvlerë në denarë në pajtim me dispozitat e nenit 16 paragrafi (1) pika 13) dhe nenit 23 paragrafi (1) pika 8);
 - 8) I propozon Kuvendit zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv;
 - 9) I propozon Kuvendit zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryetarit të Gjykatës së Nderit, anëtarët e Gjykatës së Nderit, Prokurorin e Odës, zëvendësit e tij dhe mbrojtësit e Odës;
 - 10) I propozon Kuvendit zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryetarëve të komisioneve të përhershme dhe anëtarët e komisioneve të përhershme;
 - 11) E emëron dhe e shkarkon sekretarin e Odës;
 - 12) I propozon Kuvendit tre nënëkryetarë të Odës, duke e respektuar parimin e pranisë së tre segmenteve për nivelin primar, sekondar dhe terciar;
 - 13) I propozon Këshillit Ekzekutiv kandidatë për zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryeredaktorit dhe redaktorit përgjegjës si dhe këshillit redaktues dhe Informatorit të Odës;
 - 14) organizon dhe drejton punën e shërbimit profesional të Odës dhe
 - 15) kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë Statut ose me akte të tjera të Odës.

(2) Kryetari i Odës ka të drejtë me një akt të caktuar që e konsideron se Kuvendi ose Këshilli Ekzekutiv e ka miratuar atë në kundërshtim me Kushtetutën e RM së Veriut, ligjet apo këtë Statut, pavarësisht se me çfarë shumice është miratuar, të njëjtin mund t’ia ndalë hyrjen në fuqi dhe ta dorëzojë me shkrim mendimin e tij .

(3) Nëse Bordi Ekzekutiv në seancën e ardhshme përsëri e miraton aktin nga paragrafi (2), kryetari i Odës ka të drejtë të kërkojë për të njëtin të deklarohet Kuvendi i Odës.

(4) Kuvendi në seancën e parë të ardhshme do ta shqyrtojë aktin nga paragrafi (2) dhe nëse miratohet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i delegatëve, Kryetari i Odës do të nënshkruejë aktin, por ka të drejtë të ndërmarrë masa ligjore për shqyrtimin e mëtejshëm të aktit.

(5) Nëse Kuvendi nuk e konfirmon aktin nga paragrafi (3) të këtij nenit, atëherë konsiderohet se akti nuk ka qenë i miratuar.

Neni 30

(1) Kandidati i propozuar për Kryetar propozon Zëvendëskryetarin e Odës nga radhët e anëtarëve të Odës.

(2) Në rastin e propozimit të Zëvendëskryetarit të Odës, merret parasysh përfaqësimi drejtë dhe adekuat i pjesëtarëve të komuniteteve në RMV të cilët numërojnë 20% të popullsisë së RMV, përvèç rasteve kur Kryetari është pjesëtar i komuniteteve që përbëjnë 20% të popullsisë së RMV.

(3) Kryetari dhe zëvendëskryetari i Odës zgjidhen së bashku me votim të fshehtë, përvèç nëse Kuvendi vendos që votimi të jetë publik, me shumicë të numrit të përgjithshëm të delegatëve në Kuvend.

Neni 31

(1) Zëvendëskryetari i Odës e zëvendëson Kryetarin e Odës gjatë mungesës së tij.

(2) Kryetari i bartë të drejtat, kompetencat dhe përgjegjësitetë të caktuara zëvendëskryetarit dhe kërkon përgjegjësi për ushtrimin e të drejtave dhe obligimeve të tij.

(3) Zëvendëskryetari i nënshkruan të gjitha vendimet dhe aktet nga puna materiale dhe financiare e Odës bashkë me Kryetarin e Odës.

(4) Në rast të pengimit ose mungesës së Kryetarit dhe zëvendëskryetarit, Kryetarin e zëvendëson një nga tre nënkyetarët, i autorizuar nga Kryetari i Odës.

Neni 32

(1) Propozimi për shkarkimin e Kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Odës, drejtuar Kuvendit, mund të parashtrojnë të paktën 1/3 (një e treta) e delegatëve të Kuvendit ose së paku 3 (tre) Këshilla të Odës.

(2) Kryetari dhe zëvendëskryetari i Odës mund të shkarkohen me 2/3 (dy të tretat) e shumicës së numrit të përgjithshëm të delegatëve në Kuvend, me votim të fshehtë.

(3) Procedura për zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Odës më hollësishët shtjellohet me akt të veçantë dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Neni 33

(1) Oda ka tre Nënkyetarë.

(2) Nënkyetarët e Odës i zgjedh Kuvendi nga radhët e delegatëve të zgjedhur në Kuvend me propozimin e Kryetarit të Odës, me votim publik.

(3) Nënëkryetarët e Odës mund të shkarkohen me propozim të Kryetari të Odës, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të delegatëve në Kuvend, me votim publik.

5.5 Gjykata e Nderit të Odës.

Neni 34

(1) Gjykata e Nderit është organ i pavarur i Odës e cila, me kërkesë të Prokurorit të Odës, në përputhje me këtë Statut dhe aktet e Odës, diskuton dhe vendos për përgjegjësinë e anëtarëve të Odës për shkeljet e kryera etike, deontologje dhe nga pikëpamja profesionale, për shkelje të Statutit dhe Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe mosrespektimin e vendimeve dhe akteve të Odës.

(2) Për shkeljet e bëra nga paragrafi (1) i këtij neni, Gjykata e Nderit në masat e mëposhtme të cilat evidentohen në dosjen e shkaktarit të shkeljes shqipton:

- 1) paralajmërimin;
- 2) paralajmërimin publik;
- 3) gjobë në të holla;
- 4) ndalimin e pjesëmarrjes në punën e organeve të Odës;
- 5) marrje të përkohshme ose të përhershme të licencës.

(3) Gjykata e Nderit mban evidencë për masat e shqiptuara për shkeljet e ligjit, Statutit dhe Kodit të Deontologjisë Mjekësore.

Neni 35

(1) Gjykata e Nderit përbëhet nga Kryetari i Gjykatës së Nderit dhe të paktën 16 (gjashtëmbëdhjetë) anëtarë.

(2) Anëtarët e Gjykatës së Nderit i zgjedh Kuvendi me propozimin e Kryetarit të Odës, nga radhët e anëtarëve të Odës që kanë përvojë pune të paktën 5 (pesë) vjet, përvojë në specializim dhe që kanë reputacion në mjeshterinë e cilin punojnë dhe jetojnë.

(3) Në punën e Gjykatës së Nderit, me propozimin e Kryetarit të Gjykatës së Nderit, mund të marrin pjesë dhe juristë të shquar me praktikë të pasur gjyqësore, pa të drejtë vendimmarrjeje.

Neni 36

(1) Gjykata e Nderit gjykon në këshillat e shkallës së parë dhe të dytë.

(2) Këshilli i shkallës së parë përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe zëvendës të tyre, ndërsa këshilli i shkallës së dytë është i përbërë nga 5 anëtarë dhe zëvendës të tyre.

(3) Kryetari i Gjykatës së Nderit kryeson Këshillin e Shkallës e Parë dhe Dytë, pa të drejtë vendimmarrjeje .

(4) Këshilli i Shkallës së dytë vendos në rast ankese të vendimit nga Këshilli i shkallës së parë dhe vendimet e tij janë përfundimtare.

(5) Gjykata e Nderit përgjigjet për punën e saj para Kuvendit dhe parashtron raport vjetor për punën e saj.

5.6 Prokurori dhe Zëvendësprokurorët e Odës

Neni 37

(1) Oda ka një prokurorë dhe dy zëvendësprokurorë të Odës.

(2) Prokurorin e Odës dhe zëvendësit e tij i zgjedh Kuvendi nga radhët e anëtarëve të Odës që kanë përvojë pune së paku 5 (pesë) vjet përvojë specializimi dhe që kanë reputacion në mjedisin ku punojnë dhe jetojnë.

Neni 38

(1) Prokurori i Odës dhe zëvendësit e tij janë organe të Odës të cilët kanë të drejtën dhe obligimin që ta ndjekin procedurën kundër një anëtarit të Odës, për të cilin ekziston dyshimi i justifikuar se e ka shkelur Ligjin, Statutin apo Kodin e Deontologjisë Mjekësore.

(2) Prokurori i Odës dhe zëvendësit e tij e parashtrojnë dhe e përfaqësojnë prokurorinë dhe janë të pavarur në punën e tyre.

5.7. Mbrojtësit e Odës

Neni 39

(1) Kuvendi, me propozim të Kryetarit të Odës, zgjedh 10 (dhjetë) mbrojtësit e Odës nga radhët e anëtarëve të Odës.

(2) Mbrojtësit e Odës i mbrojnë interesat e anëtarit të pandehur të Odës në procedurë para Gjykatës së Nderit.

(3) Interesat e mjekut të paditur të mjekësisë para Gjykatës së Nderit, në cilën do shkallë, mund t'i mbrojë edhe vetë i akuzuari, një ose më shumë nga mbrojtës të Odës ose një avokat të angazhuar nga i padituri.

Neni 40

(1) Propozim për shkarkimin e Kryetarit dhe anëtarit të Gjykatës së Nderit, Prokurorit të Odës dhe zëvendësit e tij dhe mbrojtësit të Odës, drejtuar Kuvendit mund të parashtrojë Kryetari i Odës ose të paktën 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm i delegatëve në Kuvend.

(2) Organizimi dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me punën e prokurorit të Odës, zëvendësit dhe mbrojtësit e tij rregullohen me akt të miratuar nga Kuvendi.

6. KËSHILLAT E ODËS

1) Anëtarët e Odës janë të organizuar në Këshillat e Odës.

(2) Këshillat e Odës formohen në territorin e komunave në të cilat ka së paku 10 (dhjetë) anëtarë të Odës, dhe në komunat ku janë më shumë se 350 (treqind e pesëdhjetë) anëtarë formohet një bord i ri.

(3) Nëse numri i anëtarëve në Këshillin Komunal zgjedhet nën minimumin e përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, i bashkëngjitet pjesës më e afërt territoriale e Këshillit Komunal.

(4) Shkupi është i organizuar në 5 (pesë) njësi territoriale: Gazi Babë, Karposh, Kisella Vodë, Qendër dhe Çair, të cilat sipas parimit formojnë Këshillat e Odës për çdo 350 (treqind e pesëdhjetë) anëtarë një bord të ri.

(5) Me akt të veçantë të miratuar nga Këshilli Ekzekutiv i Odës, më hollësishët përcaktohet rregullimi strukturor dhe organizativ i Këshillave të Odës.

Neni 42

(1) Këshillat e Odës janë përgjegjëse për zbatimin e akteve, vendimeve, qëndrimeve dhe konkluzioneve të organeve të Odës për rajonin e tyre dhe kanë detyrat si më poshtë:

- 1) të kujdesen për marrëdhëniet e mira ndërmjet anëtarëve të Odës dhe ta zgjedhin kontestin midis tyre;
- 2) të paraqesin kërkesë në Komisionin për Çështje Etike dhe Juridike, për ndërmjetësim në zgjidhjen e kontestit ndërmjet mjekëve që nuk mund të zgjidheshin në bord;
- 3) të dorëzojnë fletëparaqitje për ngritjen e procedurës disiplinore te prokurori i Odës;
- 4) t'i marrin dhe t'i shqyrtojnë nismat, propozimet dhe kërkesat e mjekëve në razonin e tyre dhe t'ua dorëzojnë organeve të Odës;
- 5) të mbajnë evidencë për anëtarët e Odës nga razoni i tyre dhe ta informojë Odën;
